

VENDIM
Nr. 137, datë 7.6.2021

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 478, SERIA T20,
PËR VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË
SHOQËRISË “HEC ZALL XHUXHË” SHPK ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s
NR. 242, DATË 21.12.2020, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 42, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 5, germa “a”, të nenit 6 dhe nenit 7, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; të nenit 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; të pikës 5.1, të “Kushteve të licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.6.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 87/1 prot., datë 3.6.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes,

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 242, datë 21.12.2020, Bordi i ERE-s vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “HEC Zall Xhuxhë” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, me kushtin që shoqëria të depozitojë, brenda 3 muajve nga marrja e këtij vendimi:

i. vërtetimin për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore;

ii. dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera, etj.);

iii. sasinë e energjisë elektrike të parashikuar për t’u tregtuar në gwh/për pesë vitet e licencës së tregtimit të energjisë elektrike;

iv. kapitalin financiar të parashikuar për ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike.

2. Mosplotësimi i kushteve të këtij vendimi përbën shkak për rishikimin e tij.

- Në vijim të këtij licencimi me kusht, shoqëria ka depozituar në ERE vërtetimin për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore, duke plotësuar kështu kushtin e vendosur në pikën 1, germa “i”, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 242/2020, si dhe ka paraqitur kërkesën për të shtyrë me 30 ditë afatin e plotësimit të dokumentacionit të mbetur ende pa plotësuar.

- Bazuar në dokumentacionin e depozituar nga shoqëria dhe në kërkesën e saj, me vendimin nr. 107, datë 22.4.2021, Bordi i ERE-s ka vendosur që shoqëria të depozitojë në ERE, brenda 60 ditëve, duke filluar ky afat nga data 28.3.2021, dokumentacionin si më poshtë:

i. dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera, etj.);

ii. sasinë e energjisë elektrike të parashikuar për t’u tregtuar në gwh/për pesë vitet e licencës së tregtimit të energjisë elektrike;

iii. kapitalin financiar të parashikuar për ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike.

- ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e Bordit nr. 107/2021, me shkresën nr. 451/3 prot., datë 4.5.2021 dhe me shkresën nr. 451/4 prot., datë 18.5.2021, i ka rikujtuar asaj afatin për plotësimin e dokumentacionit, sipas përcaktimeve të vendimit të Bordit nr. 107/2021, duke sjellë në vëmendje se mosplotësimi i dokumentacionit brenda datës 26.5.2021, do të përbëjë kusht për rishikimin e vendimit.

- Nuk rezulton që shoqëria të ketë kthyer përgjigje ndaj shkresave të ERE-s.

- Nga analiza e kryer rezulton se shoqëria nuk ka përmbushur brenda afatit kushtet e përcaktuara në vendimin e licencimit e po ashtu nuk ka dokumentuar në ERE përpjekjet e saj për përmbushjen e tyre.

- Në zbatim të nenit 7, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, shoqëria ka të drejtë të përgjigjet me shkrim brenda 30 ditëve nga marrja dijeni e fillimit të kësaj procedure.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për heqjen e licencës nr. 478, seria T20, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “HEC Zall Xhuxhë” sh.p.k. me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 242, datë 21.12.2020, të ndryshuar.

2. Shoqëria mund të paraqesë argumentet e saj me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit, për fillimin e procedurave, për heqjen e licencës.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti